

PRODHIMI I PLEHRAVE FOLIAR
“VLERA” SH.P.K.

RAPORT
I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR PRODHIMIN E PLEHRAVE
FOLIAR - GJURKOC, SHTIME

Qershor, 2024

PRODHIMI I PLEHRAVE FOLIAR
“VLERA” SH.P.K.

RAPORT

I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR PRODHIMIN E PLEHRAVE
FOLIAR - GJURKOC, SHTIME

PERSONI I LICENCUAR:
Dr. Muharrem Salihaj Inxh.
Dip. i Teknologjise

PARASHTRUESI I KËRKESËS:
Diellon Mufail Salihaj

Qershor, 2024

PËRMBAJTJA

1.0. Hyrje	4
2.0.Objektivi i VNM-së	5
2.1.Fusha e zbatimit të VNM-së.....	5
2.2 Kërkesat e përgjithshme për vlrësimin e ndikimit në mjedis-VNM të një projekti	6
2.2 Qellimi i projektit	6
3.0.Baza ligjore per hartimin e raportit	7
4.0. Identifikimi dhe pershkrimi i ndikimeve ne mjedis	9
4.1.Përshkrimi i lokacionit dhe mjedisit	10
4.2. Pozita gjeografike e lokacionit	11
4.3. Përshkrimi i Objektivit.....	12
5.0. Përshkrimi i procesit teknologjik	13
5.1 Procesi teknologjik i prodhimit te fertilizuesve inorganik	14
5.2.Procesi teknologjik i prodhimit te plehut foliar organik.....	15
6.0. Identifikimi dhe përshkrimi i ndikimeve në mjedis	17
6.1. Përshkrimi i Mjedisit.....	17
6.2. Relievi.....	17
6.3. Hidrogjeologjia	18
6.4. Pedologjia.....	18
6.5. Natyra dhe Biodiversiteti	18
6.6. Bimesia dhe Vegjetacioni.....	19
6.7. Bota shatzore-Fauna.....	19
6.8. Peisazhi	19
6.9. Zhurma-Ndotja Akustike	20
7.0.Pershkrimi i masave per zvogelimin e ndikimeve ne mjedis	20
7.1 Ndikimet në vendbanim dhe popullatë	20
7.2. Ndikimi ne ndotjen e ujit dhe tokës	21
7.3. Ndikimi ne ndotjen e ajrit.....	21
7.4. Mbeturinat e Ngurta	21
7.5. Ndikimet ne Peisazh	22
7.6. Ndikimet ne Flore dhe Faune	22

8.0. Ndërmarrja e masave parandaluese në zvoglimin e ndikimeve në toke uje dhe ajer ..	22
8.1 Programi i Monitorimit.....	23
9.0. Masat rehabilituese për sanimin e gjendjes pas mbylljes së veprimtarisë ..	23
9.1 Rikultivimi Teknik	23
9.2 Rikultivimi Agroteknik	24
9.3 Rikultivimi Biologjik	24
10.0. Përfundimi	25
11.0. Literatura.....	26
Shtojca	27

1.0. Hyrje

Vlerësimi i ndikimit ne mjedis-VNM siguronë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit përmes parandalimit të dëmeve dhe efekteve negative në mjedis të projekteve qofshin ato publike apo private. Ky raport përcakton rregullat dhe procedurat për identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve të projekteve në mjedis, për të siguruar parandalimin ose zvogëlimin e ndikimeve negative të projekteve të propozuara publike dhe private; Ky raport është nje kategori ligjore dhe obligative per marrjen e pelqimit mjedisor per te gjitha veprimtarite dhe subjektet e ndryshme ekonomike qe ne nje menyre apo tjetere e ndikojne mjedisin e gjere, dhe paraqet një dokument të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për marrjen e pëlqimit mjedisor nga autoritetet përgjegjëse të Ministrise se Mjedisit dhe Planifikimi Hapesinore si kusht për marrjen e lejës per fillimin e veprimtarisë per prodhimin e plehrave foliar.

Raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis për prodhimin e plehrave foliar me pronar **Diellon Salihaj** me numer personal **1170676374**, gjendet ne Gjurkoc, Komuna e Shtimes buze magjistrales Shtime-Prishtine dhe paraqet një dokument të rëndësishëm dhe të domosdoshem për marrjen e kesaj leje. Përmes këtij raporti do të përkufizohen të gjitha ndikimet relevante që mund të paraqiten ne mjedisin jetësor dhe ne mjedisin e gjerë ne pergjithesi nga ushtrimi i kesaj veprimtarie.

Hartimi i raportit për vlerësimin e ndikimit në mjedis bëhet me qëllim që në mënyrë transparente të paraqitet ndikimi në mjedis i veprimtarise në mënyrë që të mundësohet ruajtja e mjedisit dhe qe impakti negativ mjedisor te jete sa me i vogel. Ky raport është punuar, duke u bazuar në projektin e ndërtimit, karakteristikat e lokacionit, gjendjen ekzistuese të mjedisit rreth lokacionit ku planifikohet të ndërtohet zhvillohet kjo veprimtari si dhe dokumentacionit teknik ekzistues.

Detyra e përgatitjes së këtij raporti kryesisht ka për qëllim identifikimin e burimeve të ndotjes, vlerësimin e ndikimit të tyre në mjedis si dhe propozimin e veprimeve për parandalimin apo së paku zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis gjer në kufijtë e lejuar.

Të gjitha konstatimet dhe rekomandimet për mbrojtjen e mjedisit që dalin nga ky raport, duhet të merren për bazë , gjatë fazës së aktiviteteve të ndertimit, ushtrimit të kesaj veprimtarie dhe pas përfundimit të aktivitetit të veprimtarisë.

2.0 Objektivi i VNM-së

Objektivi i raportit të VNM-së është përcaktimi i kërkesave, përgjegjësi, rregullave dhe procedurave për vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme negative në mjedisin e Republikës së Kosovës, të projekteve të propozuara, private apo publike. Pra objektivat duhet të jenë:

- Specifike
- Të matshme
- Të arritshme
- Reale
- Të përcaktuara në kohë

2.1. Fusha e zbatimit të VNM-së

Hartimi i vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis në formën fillestare merret në konsiderim për t'u zbatuar për projektet e propozuara, private apo publike, të cilat mund të shkaktojnë ndikime të rëndësishme negative, të drejtëpërdrejta ose jo, në mjedis, si pasojë e madhësisë, natyrës apo vendndodhjes së tyre.

2.2. Kërkesat e përgjithshme për vlerësimin e ndikimit në mjedis-VNM të një projekti

1. Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshinë përcaktimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta mjedisore të zbatimit apo moszbatimit të projektit.
2. Ndikimet mjedisore të projektit vlerësohen në lidhje me gjendjen e mjedisit në territorin e prekur në kohën e paraqitjes së raportit përkatës për vlerësimin e ndikimit në mjedis të projektit.
3. Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshinë përgatitjen, zbatimin, funksionimin dhe mbylljen e tij sipas rastit edhe pasojat e mbylljes së veprimtarisë dhe dekontaminimin, pastrimin apo rikthimin e zonës në gjendjen e mëparshme, nëse një detyrim i tillë parashikohet me ligj. Vlerësimi përfshinë, sipas rastit, si funksionimin normal, ashtu edhe mundësinë për aksidente.
4. Vlerësimi i projektit përfshinë, gjithashtu, propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve të tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin gjatë zbatimit të projektit, duke përfshirë edhe vlerësimin e efekteve të pritshme të masave të propozuara

2.3. Qëllimi i projektit

Qëllimi primar i këtij projekti është që të krijoj të mira materiale përmes kësaj veprimtarie prodhuese, por pa e dëmtuar dhe ndikuar negativisht mjedisin e gjerë. Parashikimet potenciale të ndikimeve në mjedis që mund të ndodhin si dhe masat e propozuara për parandalimin dhe zvogelimin e tyre në mjedis, pastaj masat për rehabilitimin dhe sanimin e dëmeve pas

përfundimit të projektit qoftë të tokës, ujit, apo ajrit kuptohet nëse janë dëmtuar mbi normat e lejuara sipas ligjeve të Republikës të Kosovës dhe konventave ndërkombëtare për mjedis. Projektet e tilla duhet të jenë të ballancuara në rrafshin ekonomik, pastaj në atë social dhe mjedisor. Vetëm në këtë mënyrë duke i marrë parasysh këta tre parametra në sigurojmë një zhvillim ekonomik të mirëfillt dhe një mjedis të qëndrueshëm.

3.0. Baza ligjore për hartimin e raportit

Ligji i parë për mbrojtjen e mjedisit në Kosovë daton në vitin 2003. Tani është hartuar dhe aprovuar Ligji i ri për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025, ndër të tjera në të potencohet se të gjitha veprimtaritë e personave fizike dhe ligjor, vendas apo të huaj, që ushtrojnë veprimtari të reja dhe kanë ndikime të theksuara negative në mjedis, do të jenë temë e vlerësimit të ndikimit në mjedis. Në lidhje me vlerësimin e ndikimit në mjedis – VNM është aprovuar dhe funksionon Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis LIGJI NR. 08/L-181 i cili përcakton të gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të VNM-së. Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis ka për qëllim për të siguruar mundësimin e një vlerësimi të përgjithshëm me ndërthurje të ndikimeve mjedisore të projekteve apo veprimtarive që do të realizohen me qëllim që të parandalojnë dhe të zvogëlojnë apo mënjanojnë efektet negative në mjedis në kohën e duhur. Fusha e administrimit të mbeturinave në Kosovë rregullohet përmes Ligjit për mbeturina, Nr. 04/L-060. Qëllimi i këtij Ligji është mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe të mjedisit nga ndotja dhe rreziku nga mbeturinat, përmes administrimit të mirëfilltë (të qëndrueshëm) të mbeturinave, duke krijuar kushte për parandalimin dhe zvogëlimin e prodhimit të mbeturinave dhe rrezikshmërisë së tyre. Si bazë themelore për hartimin e

Raportit të Vlerësimit të Ndikimit ne Mjedis per prodhimin e plehrave foliar ne Gjurkoc të Shtimes janë shfrytëzuar :

- Ligji për VNM Nr. 08/L-181
- Ligji i ndertimit Nr. 04/L-110
- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për mbeturina Nr. 04/L-060
- Lgji per kimikate Nr. 04/L-197
- Ligji per plehrat artificiale Nr. 2003/10
- Ligji për tokën bujqësore Nr. 02/L- 26
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 03/L-160
- Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr.03/L-233
- Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102.
- Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2007 mbi rregullat dhe normat e shkarkimeve ne ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes.
- Udhëzimi administrativ kompetencat e zotëruesit dhe operatorit për trajtimin e mbeturinave (08/2007).
- Udhëzimi administrativ për vlerat kufizuese të efluentit që shkarkohet ne trup ujorë dhe ne rrjetin e kanalizimit publik (13/2008).
- Udhëzimi administrativ për nivelet maksimale të lejuara të shkarkimit dhe shpërndarjes të ndotësve ne tokë.

Projekti i propozuar nuk shtrihet në zonën e ndieshme mjedisore dhe nuk paraqet ndonjë ndikim negativ në mjedis duke marrë për bazë distancën e mjaftueshme nga shtëpitë tjera banuese të fshatit

Gjatë hartimit të raportit për vlerësimin e ndikimit në mjedis përpos vizitës që i është bërë lokalitetit, konsultimeve me pronarin dhe ekspertët që udhëheqin procesin për prodhimin e plehrave foliar janë shfrytëzuar edhe:

- Çertifikata e regjistrimit të biznesit
- Çertifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme
- Plani i situacionit
- Kopja e planit të ngastrës
- Harta e rajonit të gjërë

Krahas parashikimeve themelore nga rregullat ligjore të cekura më lartë për nevoja të hartimit të raportit të VNM-s janë shfrytëzuar edhe rregullativa tjera ligjore, duke përfshirë ligjet aplikative të cilat tani janë në fuqi. Duke marrë parasysh faktin se një pjesë e madhe e specifikave mjedisore nuk janë përfshirë në kuadër të rregullativës së sipërsënuar, për nevojat e hartimit të këtij raporti është shfrytëzuar edhe rregullativa relevante ndërkombëtare si dhe direktivat përkatëse për mjedis si që është direktiva e VNM-s (85/337/EEC).

4.0. Identifikimi dhe përshkrimi i ndikimeve në mjedis

Raporti i VNM-se do të bazohet në ligjin Nr. 08/L-181 për vlerësimin e ndikimit në mjedis i publikuar në gazetën zyrtare 2/2023 është bazë për kornizën ligjore që do të promovojë një ngritje të mjedisit të shëndetshëm për komunitetin me sjelljen graduale të standardeve për

mjedis të Bashkimit Evropian dhe Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH). Projekti i propozuar nuk shtrihet në zonën e ndieshme mjedisore, sipas observimit dhe pamjes së lokalitetit nga personat e licencuar, për lëmin e Mbrojtjes së Mjedisit. Leja leshohet duke u bazuar në Planin e Biznesit për Diellon Mufail Salihaj për prodhimin e plehrave foliar dhe duke u bazuar në informatat e prezantuara dhe nga gjendja e observuar në teren.

4.1. Përshkrimi i lokacionit dhe mjedisit

Karakteristikat themelore të gjendjes ekzistuese të lokacionit janë bazë themelore për hartimin e Raportit të VNM-s. Hulumtimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese është bërë duke i shfrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në teren. Për t'u definuar gjendja ekzistuese në mënyrë të kënaqshme dhe për t'u krijuar një bazë reale për hulumtim të ndikimeve të mundshme, në kuadër të gjendjes ekzistuese janë prezantuar edhe të dhënat relevante që kanë të bëjnë me të dhënat ekzistuese morfologjike, gjeologjike, hidrologjike, hidrografike dhe meteorologjike.

Komuna e Shtimes gjendet në pjesën qendrore të Kosovës, apo në koordinatat 42.4333° N, 21.0333° E. Territori i komunës së Shtimes ka një sipërfaqe prej 134 km² (13,450.8 hektarë), gjegjësisht, 1,2 për qind të territorit të Kosovës. Afër 48,4 % e territorit të komunës është tokë bujqësore dhe bujqësia është një nga prioritetet zhvillimore të komunës.

Komuna ka 23 vendbanime duke përfshirë qytetin e Shtimes dhe 22 fshatra, prej të cilave 13 shtrihen në pjesën kodrinore - malore, ndërsa 9 prej tyre në pjesën rrafshinore. Shumica e fshatrave të komunës janë të lidhura me Shtimen me rrugë të asfaltuara. Nga regjistrimi i fundit i popullsisë, banesave dhe ekonomive familjare, sipas rezultateve preliminare të publikuara të mërkurën nga Enti i Statistikës së Kosovës (ESK), ka rezultuar se Komuna e Shtimes ka 27 mijë e 288 banorë.(13.839 meshkuj dhe 13.449 femra). Nga këto shifra del se prej 34 komunave, në të cilat

është bërë regjistrimi i popullsisë, Shtimja është komuna e njëzet e katërt me radhë për ka numri i banorëve.

Kryqëzimi i akseve rrugore të rëndësishme në relacionet Prizren - Prishtinë dhe Prizren-Ferizaj-Shkup janë segmente me rëndësi për zhvillimin e mëtutjeshëm të komunës.

Komuna e Shtimes kufizohet me Komunën e Ferizajt, Lipjanit dhe Therandës (Suharekës).

Qyteti i Shtimes është 31 km larg nga kryeqendra e Kosovës (Prishtina), 48 km nga Prizreni dhe 13 km nga Ferizaj. Shtimja është udhëkryq i rrugëve regjionale, këtë segment duhet ruajtur dhe zgjeruar edhe gjatë hartimit të Planit Gjeneral Urbanistik .




Fig.1. Harta e komunës së Shtimes

4.2. Pozita gjeografike e lokacionit

Lokacioni ku do të ndërtohet ferma ne Gjurkoc te Shtimes, eshte ne nje largesi prej 5 km nga qyteti i Shtimes dhe ka nje lartesi mbidetare rreth 550 m nga niveli i detit. Ngastra 00528-1 që gjendet në lokacionin Zona Kadastrale Gjurkoc me përpjestim 1:2500 sipas kopjes së planit përfshinë një sipërfaqe prej 4137 m². Tereni ku ndodhet objekti per prodhimin e plehrave foliar eshte i rrafshet dhe eshte shume i pershtatshem per kete veprimtari.

Ky objekt eshte ndertuar në pjesën e njësisë kadastrale P-72809030-00528-1 qe ka siperfaqe S=4137 m² ne magjistralen Shtime-Prishtine”, Komuna e Shtimes. Ngastra është në pronësi private në emër të Diellon Mufail Salihaj dhe eshte ne zonen ku lejohet ndertimi i objekteve bujqesore dhe prodhuese

Në afërsi të drejtpërdrejte të ngastrës ku është ndertuar objekti ndodhet nje ferme qe eshte ndertuar me heret dhe disa objekte të banimit. Objekti i banimit më i afert ndodhet në largësi prej me shume se 200 m nga kjo pike, kurse objektet banuese tjera gjenden në largësi akoma më të mëdha. Këto vlerësime shërbejnë si bazë për kuantifikimin e ndikimeve të mundshme dhe për përcaktimin e masave të nevojshme mbrojtëse, duke marrë parasysh se kemi të bëjmë me një veprimtari që mund të ketë ndikime mjaft të vogla në mjedis.



Fig.2 Pamja satelitore e vendit ku eshte ndertuar objekti

4.3. Përshkrimi i objektit

Objekti eshte ndertuar me material te forte, beton dhe blloqe betoni i projektuar dhe destinuar per veprimtari prodhuese,ku kati perdhes ka siperfaqe prej 450 m² i destinuar vetem per prodhim dhe gjithashtu posedon edhe katin e 2 me siperfaqe prej 150 m², per zyra dhe administrate. Ne hapesirat prodhuese gjindet toaleti dhe hapesirat per dush ne dispozicion te punetoreve. Objekti ka parking te mjaftueshem dhe eshte i ndertuar ne nje hapsire te nje parcele me 4127 m², ka qasje ne rrugen kryesore magjistrale Shtime - Lipjan dhe te gjitha predispozitat urbanistike per nje objekt serioz per zhvillimin e veprimtarive prodhuese.

Lartesi e objektit ne hyrje eshte 4,5 m qe mundeson qasjen e e automjeteve transportuese te çfardo niveli te hyjne ne objekt per t'u shkarkuar lenda e pare pa patur pengesa te natyres teknike. Objekti eshte i ndertuar me leje ndertimi ka rrjetin elektrik, ka burimin e ujit vetanak ku furnizohet me pompe dhe ka burimin e energjis solare me kapacitet 3.5 kW i mjaftueshem per ndriçim dhe furnizimin me energji te pompave te ujit. Objekti gjindet ne periferi, larg fshatrave te banimit dhe

nuk interferon ne ndonje objekt te banimit. Objekti ka ndricim natyral te mjaftueshem dhe ventilim te mire.

5.0. Përshkrimi i procesit teknologjik

Plehrat jane substanca fertilizuese te bimeve qe perdoren gjeresisht ne bujqesine intensive.

Perpos plehrit themelor qe perdoret te bimet qe kryesisht jane plehra komplekse minerale ne forme te granulave te Azotit, Fosforit dhe Kaliumit. Gjate vegetacionit bimet kane nevojte edhe per nderhyrje plotesuese te fertilizuesve te tretshem ne uje qe mund te jene kripera te Azotit, Fosforit, Kaliumit, Kalciuimit, Magnezit, Squfurit etj. Fermerert per te arrite rendimentin e deshiruar te bimet gjate gjithe vegetacionit perdorin rregullisht tretesira te ketyre komponimeve. Dhe pikerisht keto plehrat qe perdoren si tretesira, ku bimet i absorbojne materiet ushqyese permes gjetheve quhen plehra foliar. Avantazhi kryesor i perdorimit te tretesirave foliar eshte se japin efekte te menjehershme ne permiresimin e gjendjes se bimes. Sigurisht qe kombinimet qe mund e te behen kerkojne nje staf te pergatitur mire dhe te specializuar ne fushen e mbrojtjes dhe te ushqyerit e bimeve.

Keto plehra mund te jene te natyres organike dhe inorganike. Plehrat foliar te natyres organike preferohet te kene permbajtje te lendes organike mbi 30 % , ku elementet ushqyese per bimen bazohen ne permbajtjen e Acidit Humik dhe Acidit Fulvik. Nderkaq plehrat, perkatesisht fertilizuesit inorganik bazohen ne elementet ushqyese te cilat vijne ne forme te kriperave te Azotit, Fosforit, Kaliumit, Kalciuimit, Magnezit etj.

Prodhimet qe kemi planifikuar te prodhohen ne ndermarrjen tone jane kombinime dhe formulime te ketyre kriperave qe jane te tretshme ne uje.

Lenda e pare e fertilizuesve inorganik vjen ne forme kristalore e paketuar ne thase polipropilene dhe duke i njohur kerkesat fiziologjike te bimeve, te kulturave te ndryshme bujqesore, stafi yne

profesional do të bëjë tretjen dhe kombinimin e këtyre elementeve, sipas kërkesave që kanë bimët për të arritur një rendiment sa më të lartë. Këto formulime do të paketohen në ambalazhe plastike duke filluar nga 50 ml deri në 5 lit. Gjate kësaj procesi nuk do të ketë fare ndotje të mjedisit, sepse lenda e parë e fertilizuesve inorganik vjen në ambalazhe plastike në gjendje kristalore. Ndërsa lenda e parë e fertilizuesve organik importohet si tretësirë e lengshme në formë të Acidit Humik dhe Acidit Fulvik e ambalazhuar si tretësirë e lëngjet e koncentruar, ku pas tretjes në koncentrim të ndryshëm krijojmë formulime të përshtatshme për bimën .

5.1 Procesi teknologjik i prodhimit të fertilizuesve inorganik

Procesi teknologjik i formulimit të fertilizuesve inorganik do të rrjedhë sipas kësaj dinamike: Fertilizuesit kristalor inorganikë të Azotit, Fosforit, Kaliumit, Kalciumit etj. të importuara në ambalazhe nga polipropileni formulohen në doza të caktuara dhe varesisht nga destinimi për bimë të caktuara hudhen në perzira ku bëhet tretja dhe homogjenizimi në rezervuar adekuat të plastikës dhe pas tretjes së mirë mbushen dhe kalojnë në shiritin paketues ku paketohen në ambalazhe nga 50 ml deri në 5 lit. varesisht nga kërkesat e tregut. Për nga menyra dhe procesi i formulimit të një tretësire të tillë me vlera ushqyese për kulturë bujqësore duket qartë që nuk ndikon aspak në ndotjen e mjedisit .

Formulimi i kësaj produkti do të bëhet duke e ruajtur proporcionin e makroelementeve N:P:K me nga 8% si elemente bazike për ushqyerjen e bimëve dhe duke iu shtuar edhe mikroelemente sipas tabelës së mëposhtme :

Tabela1. Përbërja e makroelementeve

Përmbajtja	Sasia në %
Azot (N)	8%
Fosfor (P₂O₅)	8%
Kalium (K₂O)	6%

Tabela 2. Përbërja e mikroelementeve

Përmbajtja	Sasia në %
Bakur (Cu)	0.02% / - 0.004%
Bor (B)	0.01% / - 0.002%
Hekur (Fe)	0.02% / - 0.004%
Mangan (Mn)	0.02% / - 0.004%
Molibden (Mo)	0.001% / - 0.0002%
Zink (Zn)	0.006% / - 0.0012%

5.2 Procesi teknologjik i prodhimit të plehut foliar organik.

Produkti tjetër si fertilizues me natyrë organike që do të prodhohet, përketesisht formulohet në ndermarrjen të tone do të bëhet gjithashtu nga lenda e parë organike e cila importohet në gjendje të lenget në formë të Acideve Humike, Acideve Fulvike dhe Karbonit Organik, me një përqindje të Azotit dhe Kaliumit .

Keto tretësira organike përmirsojnë jo vetëm bimën por edhe gjendjen afatgjatë të tokës duke përmirësuar strukturën e tokës me acide humike dhe fulvike

Procesi teknologjik do të jetë i ngjashëm, lenda e parë e koncentruar e përbërësve të lartpërmendur vë nga importi, pastaj varesisht nga koncentrimi i elementeve bëhet llogaritja e përqindjes, krijohet formulimi dhe hudhet në rezervuar të plastikës, pastaj aty i shtohet sasia e ujit dhe gjatë këtij procesi paralel bëhet përzirja e tretësirës deri në tretjen e plotë dhe homogjenizimin e ngjyres. Pastaj procesi vazhdon me mbushjen e shisheve varesisht nga paketimi i cili do të jetë nga 0,25 deri në 5 lit.

Fertilizuesit organik do prodhohen sipas kesaj formule ne tabelen 3.

Tabela 3. Permbajta e produktit

Përmbajtja	Sasia në %
Lendë Organike	30%
Acide Humike + Fulvike	20%
Karbon Organik	15%
Total Azot	6%
Total K ₂ O	5%



Fig.3 Mikseri per perziejen e komponenteve te plehrave foliar

6.0. Identifikimi dhe përshkrimi i ndikimeve në mjedis

Dispozitat ligjore të republikës së Kosovës dhe Standardeve Evropiane qe parashikohen të zbatohen edhe në Kosovë, që në formë të përgjithshme po i cekim edhe në këtë raport të VNM-se.

Raporti i plotë i VNM-së që përmbanë elaboratin e kompletuar të VNM-së për një operator ekonomik do të përpilohet në rastet kur operatori ka ndikim të drejtëpërdrejtë apo të përhershëm

në: ndikimet në shëndetin e popullates, ndryshimet në popullatë, peisazh, në zona rekreative, shkarkimet në tokë, ujë, ajer, ndikimi i zhurmës dhe vibrimeve, nivelet e ndikimit të rrezatimit jonizues, ndikimi në florën dhe faunën, trashëgiminë natyrore p.sh. humbja e varieteteve bimore, dhe shtazore, dëmtimi i relikteve gjeologjike ne kontekstin paleontologjik dhe fiziko-gjeografik, ndryshimet e cilësisë dhe sasisë së ujit , degradimi i resurseve natyrore etj. Në këto raste operatorët ekonomik do të monitorohen nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë-MMPH.

6.1. Përshkrimi i Mjedisit

Karakteristikat themelore të gjendjes ekzistuese të lokacionit janë bazë për hartimin e raportit. Hulumtimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese është bërë duke i shfrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në teren. Për t'u definuar gjendja ekzistuese në mënyrë të kënaqshme dhe për t'u krijuar një bazë reale për hulumtim të ndikimeve të mundshme, në kuadër të gjendjes ekzistuese janë prezantuar edhe të dhëna relevante që kanë të bëjnë më të dhënat ekzistuese morfologjike, pedologjike, hidrologjike, hidrografike dhe meteorologjike

6.2. Relievi

Morfologjia e terrenit ku është pozicionuar objekti për prodhimin e plehrave foliar karakterizohet me një relief kryesisht të rrafshët e cila gjendet në lartësi mbidetare afër 550 m. Gjatë kryerjes së punëve ndërtimore për vendosjen e objekti është vërejtur se në aspekti gjeologjik kemi të bëjmë me një tokë humusore të zezë deri në thellësinë 2 m ,pastaj çfaqet një shtresë toke me përbërje fosilesh e cila shtresë nuk është depërtuar duke pasur parasysh se edhe vëllimi i punëve nuk ka qenë aq i madh në mënyrë që bëhet ndonjë studim gjeologjik më i hollësishëm.

6.3. Hidrogeologjia

Karakteristikat hidrogeologjike janë të thjeshta. Morfologjia, ndërtimi gjeologjik dhe tektonika janë faktorë dominant të cilët definojnë lëvizjen e ujrave sipërfaqësorë dhe atyre nëntokësorë. Në afërsi të objektit nuk ekzistojnë burime të ujit. Ujërat sipërfaqësore paraqiten vetën në sezonën e reshjeve atmosferike të cilat drenohen në kanalet natyrale. Thellësia e nivelit të ujrave nëntokësore është e rreth 12 m në sezonën e verës kurse në dimër ai nivel ngritet në 3 m në sipërfaqe. Ky ndryshim i nivelit të ujrave është konstatuar nga shpuarja e një pusi me diameter $\varnothing 1000\text{mm}$.

6.4. Pedologjia

Në aspektin pedologjik, në vendin ku ndodhet objekti ka toka të kultivuara me të lashta bujqësore me një reliev të rrafshët fushor. Gjithashtu në afërsi të objektit shihet një bimësi e mirë e zhvilluar për shkak se toka është pjellore e cila është e mjaftueshme në këtë lokacion. Në lokalitetin në fjalë toka ka ngjyrë zezë të mbyllët e aty këtu të çelët. Lagështinë e merr nga të reshurat atmosferike. Siç u cekë më lart tokat kanë ngjyrë kafe në të zezë. Tokat me ngjyrë zezë biologjikisht janë aktive dhe kryesisht përdoren si toka bujqësore, edhe pse janë toka pjellore janë të vështira për punë.

6.5. Natyra dhe biodiversiteti

Në bazë të të dhënave zyrtare të Institutit për mbrojtjen e Natyrës, nuk ekzistojnë të dhëna se në këtë teren kemi të bëjmë me ndonjë hapësirë të mbrojtur me ligj në drejtim të biodiversitetit dhe natyrës në përgjithësi. Deri më tani nuk është hasur ndonjë bimësi endemike që është në zhdukje.

6.6. Bimësia dhe vegjetacioni

Përbërja gjeologjike dhe pedologjike e tokës kushtet klimatike dhe relievi ndikojnë në zhvillimin e bimësisë. Në këtë pjesë kryesisht dominon bimësia e tipit klimatik kontinental, pra mbretëron bimësia gjetrënëse. Dominojnë kulturat bujqesore si gruri, misri, bari etj. Kryesisht bimët i takojnë tipit kserofit që do të thotë bimë që përshtaten kushteve klimatike me ndërrime stinore.

6.7. Bota Shtazore - Fauna

Në vendin ku është ndërtuar objekti për prodhimin e plehrave foliar ekziston një faunë e rëndësishme për kushtet klimatike të Kosovës në përgjithësi. Duhet të përmenden zvarraniket, brejtësit, insektet të ndryshme që e përbejnë zingjirin ushqyes, pastaj disa lloje të shpendeve etj. Nuk ka ndonjë specie që është e mbrojtur me ligj.

6.8. Peisazhi

Karakteristikat e peisazhit të hapësirës së analizuar, paraqesin njërin nga elementet për të saktësuar marrëdhëniet e tërësishme në relacionet objekt-mjedis. Karakteristikë është se këtu kemi të bëjmë me një peisazh ku dominon toka bujqesore dhe pjesërisht me shtëpi banimi. Efektet vizuale (peisazhet) janë kritere me rëndësi në ruajtjen e mjedisit dhe nëse nuk zgjidhen drejt konsiderohen si degradim i mjedisit.

6.9. Zhurma –Ndotja Akustike

Zhurma, si element i natyrës së veprimtarisë së lartëcekur ka një karakter lokal dhe pa ndikim në zonat e banuara. Zhurma për zonën e banuar duke i pasur për bazë largësitë e objekteve të banimit, është plotësisht në kufijtë e standardit dhe gjatë ditës nuk kalon 50 dB sipas standardeve ndërkombëtare dhe dispozitave ligjore që tani janë në fuqi nga MMPH e Republikës së Kosovës. Ky aktivitet nuk gjeneron ndonjë zhurmë pasiqe nuk posedon makineri apo teknologji që shkakton zhurmë.

7.0. Pershkrimi i masave për zvogelimin e ndikimeve në mjedis

7.1 Ndikimet në vendbanim dhe popullatë

Në afërsi të lokalitetit ku do të zhvillohe prodhimi i këtyre plehrave nuk ka ndonjë objekt banimi prandaj në këtë lokalitet nuk do të ketë ndikim në popullatën lokale. Zhvillimi i veprimtarisë prodhuese të plehrave foliar, për këtë rajon ka një rëndësi të vecantë për popullatën e këtij rajoni sepse për prodhimin e këtyre produkteve në këtë lokalitet do të ketë nevojë për fuqi punëtore shtesë, prandaj do të jetë i detyruar që numrin e punëtorëve ta plotësojë nga popullata vendëse.

Kurse ndikimet negative në mjedis mund të jenë, vetëm në rast se operatori, nuk i përfill kriteret mjedisore.

7.2. Ndikimi ne ndotjen e ujit dhe tokës

Gjatë procesit të prodhimit ekziston mundësia që të vije deri të rritja e ndotjes, nëse pronari nuk i përmbahet rregullave mjedisore, që kërkohen për këtë veprimtari. Pronari duhet të sigurojë që gjatë procesit të prodhimit të mos vije deri të derdhjet e pakontrolluara të lendeve të para në tokë, derdhje tjera të rrezikshme etj. I preferohet menaxhim emergjent i ujërave, në mënyrë që mos të dëmtojë ujërat nëntokësore dhe kanalizimin.

Mbledhja e ujërave të zeza që gjeneron objekti behet nëpërmjet gropës septike e cila është pjesë integrale e tij

7.3. Ndikimi ne ndotjen e ajrit

Lenda e pare që do të përdoret për prodhimin e ketyre plehrave foliar vije e gatshme dhe nuk ka ndonjë ndikim të drejteperdrejt në ndotjen e ajrit. Në afërsi të tij nuk është vërejtur ndonjë ndotës i ajrit me veprim të dëmshëm në mjedis.

7.4. Mbeturinat e Ngurta

Mbeturinat e ngurta urbane që gjenerohen nga punonjësit e këtij biznesi do të mbidhen nga Ndërmarrjen Publike Rajonale (NPR)” Pastërtia”-Njësia në Shtime që është kompetente për mbledhjen e tyre.

Kurse sa i përket mbeturinave të ngurta që gjenerohen nga ambalazhi plehrave foliar atëherë pronari është i obliguar që ato t’i deponojë në qese të materialeve të rrezikshme dhe t’i trajtojë në mënyrë të veçantë duke e kontraktuar ndonjë kompani që ben mbledhjen dhe asgjësimin e materialeve të tilla.

7.5.Ndikimet në Peisazh

Lokaliteti ku planifikohet të prodhohen keto produkte, ka filluar të merr pamjen e një vendi industrial, pasi që ne afersi të tij ndodhen edhe disa biznese tjera që ushtrojnë veprimtari të ndryshme si pompa të derivateve, mulli për bluarje të grurit etj.

7.6. Ndikimi në florë dhe faunë

E tërë veprimtaria prodhuese do të zhvillohet në objektin që është ndërtuar për këtë qëllim, prandaj ndikimi negativ në florë dhe faunë është i papërfillshëm.

8.0 Ndërmarrja e masave parandaluese në zvoglimin e ndikimeve në tokë, ujë dhe ajër

Sa i përket ndikimeve negative në ajër të projektit në fjalë duhet të ceket se ajri nuk është i ndikuar nga ky prodhim në asnjë formë pasi që kemi të bëjmë me produkte të lengshme dhe mundësia e emitimeve të grimcave në ajër nuk ekziston. Kurse sa i përket tokës dhe ujerave pronari duhet të ketë kujdes që produktet e tilla edhe pse konsiderohen plehra që janë të dobishme për kulturat bujqësore ato mund të kenë efekt negativ në tokë në koncentrim të mëdha e që nuk përjasohet edhe mundësia e infiltrimit të tyre në ujërat nëntokësore nëse rrjedhjet aksidentale janë të mëdha.

8.1. Programi i monitorimit

Për monitorimin e ndikimeve direkte të aktiviteteve prodhuese, të proceseve teknologjike, duke u bazuar në vlerësimet e ndikimit në mjedis të cilat janë ndikimi në tokë, në ajër dhe ujë.

Për këtë arsye parashihet një program monitorues. Monitorimi i ajrit, ujit, tokës dhe zhurmës duhet të veshet me kujdes nga ndonjë rrjedhje aksidentale e lëndës së pare apo të fluideve tjera si vajera dhe produkte tjera të naftës.

9.0 Masat rehabilituese për sanimin e gjendjes pas mbylljes së veprimtarisë

9.1. Rikultivimi Teknik

Në bazë të ligjeve relevante të mjedisit çdo tokë e dëmtuar si shkas i aktiviteteve prodhuese, pas skadimit të afatit të shfrytëzimit ekonomik të sipërfaqes, investitori është i obliguar që tokës t'i kthehet pamja e mëparshme. Në bazë të punimeve të kryera hartografike-pedologjike në lokalitetin e objektit duhet konstatuar se cilat pjesë iu janë nënshtruar dëmtimeve nga aktivitetet prodhuese. Për këtë arsye duhet studiuar llojet e dëmtimeve si dhe intensitetin dhe ndikimin e tyre në botën bimorë e pastaj të shqyrtohen mundësitë e sanimit të efekteve të pa-volitshme si dhe rikultivimin e kësaj pjese.

Pas përfundimit të punëve prodhuese fillon rikultivimi teknik i sipërfaqeve tokësore të degraduara. Degradimi i sipërfaqeve gjatë punimeve prodhuese shkon deri në atë masë sa bëhet zhdukja fizike e profilit pedologjik të tokës, prandaj në këtë fazë të rikultivimit propozojmë krijimin e profilit pedologjik të tokës në sipërfaqet e dëmtuara. Për formimin e shtresës së sipërme sipërfaqësore produktive të tokës parashihet mihja selektive e humusit dhe vendosja direkte në sipërfaqet punuese ku janë kryer punimet d.m.th. duhet të përvetësohet teknologjia e tillë që rikultivimi teknik

të kryhet njëkohësisht gjate zhvillimit të punimeve në objekt. Pra me përfundimin e shfrytëzimit të lokalitetit nga punimet operacionale, fillon shtresimi i dheut dhe humusit në këto hapsira. Nëse konstatojmë se shterpa nuk i plotëson kërkesat kualitative për rikultivim kemi cekë edhe më parë, duhet të konsultohen ekspertët profesional të lëmisë së agronomisë dhe të sillen sasia e dheut nga një vend tjetër me qëllim të suksesit të rikultivimit.

9.2. Rikultivimi agroteknik

Pas fazës së rikultivimit teknik fillon faza e rikultivimit agroteknik e cila fazë starton me analizimin e substratit të krijuar, për të përcaktuar vetitë agrokimike dhe pedologjike. Në bazë të analizave të propozohen masat meliorative dhe agroteknike që do të aplikohen në këtë tokë të re.

Toka është njëri prej elementeve të këtij mjedisi të cilës përveç që i ndërrohet destinimi primar, pëson degradim të rëndë, deri në zhdukjen e profilit pedologjik të saj. Kjo paraqet formën më të rëndë të dëmtimit të tokave.

9.3. Rikultivimi Biologjik

Qëllimi afatgjatë i rikultivimit biologjik është që të krijojmë ekosistem të ri në hapësirat e shfrytëzuara dhe të dëmtuara në të cilën do të krijohet baraspeshë relative e të gjitha elementeve të ekosistemit siqë janë : Toka, uji, ajri, flora dhe fauna dhe efekti ekonomik në prodhimtarinë bujqësore, blegtorale etj. Rikultivimi biologjik është faza përfundimtare me të cilën arrihet edhe qëllimi i rikultivimit. Bimët të cilat mbillen duhet t'u përshtaten kushteve klimatike dhe se me zhvillimin e tyre i japin një pamje të bukur peisazhit. Këto bimë adaptohen lehtë dhe janë rezistuese ndaj dëmtuesve biologjik. Kjo duhet të bëhet me konsultimin me ekspertët profesional të lëmisë së agronomisë dhe me autoritetin e ministrisë së bujqësisë dhe pylltarisë.

10.0.Përfundimi

Mund te konstatojme: se prodhimi i plehrave foliar nga “Vlera” SH.P.K. nuk e dëmton mjedisin (tokën,ajrin,ujin dhe resurset tjera natyrore)në fazën e tanishme dhe është në lokacion adekuat. Duke u bazuar në faktet nga tereni dhe konsulta me aplikuesin, njëherit nuk ndikon negativisht në resurset natyrore, njerëzore dhe i plotëson kushtet për të ushtruar veprimtarinë e saj. Ka hapësirë të mjaftueshme për të ushtruar këtë veprimtari dhe ka mundësi reale për infrastrukturë të mirëfilltë. Ndikimi në ambientin tokësor është i vogël dhe si i tillë mund të neglizhohet. Po ashtu ndikimi në ujërat nëntokësore dhe ujërat sipërfaqësor është fare i vogël. Mendojmë se këto të dhëna janë të mjaftueshme dhe i mundësojnë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapesinor dhe Infrastruktures, dhënien e pëlqimit mjedisor sipas kërkesës së pronarit Diellon Mufail Salihaj.

11.0.Literatura

- 1.Faqja zyrtare e komunës së Shtimes
- 2.Legjislacioni Mjedisor-mmph-rks.org
- 3.Minsitria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor,Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit (2011)..
4. Minsitria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor(2011),Strategjia për Menaxhimin e Mbeturinave(2013-2022).
5. Marsden S.(2008),Strategic Environmental Assessment in International and European Law
Beder S.2006 . Environmental principles and policies.An interdisciplinary introduction.
Earthscan.
6. Millennium Development Goals Global Targets-Local Approaches.
7. Qendra Rajonale e Mjedisit.REC-zyra në Kosovë.
- 8.AMMK-Raportet Zyrtare mbi Gjendjen e Mjedisit –annk-rks.org
- 9.European commission(2010).Communication from the Commission EUROPE 2020.A
strategy for smart,sustainable and inclusive growth.COM(2010)2020 final.Brussels.

Shtojca